Kronikë

# Trafik armësh Kosovë-Shqipëri, 10 në pranga, 2 në kërkim! Kapen 14 armë, shiteshin deri në 2500 € secila! Grupi me bazë në Burrel (EMRAT+VIDEO)

*Armët nga Kosova, transportoheshin me makina të rastit dhe linja autobusësh për t'u shitur në Tiranë dhe Shkodër. Dyshohet se grupi kriminal ka një bazë në Burrel, për të cilën vijojnë kërkimet. Në total 10 në pranga, 2 prej tyre u kapën që në prill.*

- VIDEO e momentit kur shkëmbejnë armët, trafikantët bien në kurth nga blerja e simuluar
- 'Policia shtrihu në tokë', VIDEO e arrestimeve
- Trafiku i armëve, si ra në 'kurth' grupi me blerje të simuluara

Lajmi i fundit



Alarmi për bombë në parkingun e një hoteli në Tiranë, policia: Janë evakuuar stafi dhe klientët, vijojnë hetimet

30 Maj, 20:43

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
30 Maj, 09:10 | **Përditesimi: 30 Maj, 14:24**

Share

**TIRANË**- Një grup i trafikut të armëve nga Kosova drejt Shqipërisë u godit pas një hetimi 5 mujor nga Antitrafiqet e Tiranës. Operacioni i koduar "Puzzle" çoi në pranga në total 10 anëtarë të grupit të trafikut të armëve. 8 të rinj u arrestuan ditën e sotme, ndërsa 2 të tjerë ishin arrestuar në kuadër të këtij hetimi më datë 1 prill. Ndërkohë, 2 persona janë shpallur në kërkim, të cilët siguronin armët në Kosovë dhe qytete të Shqipërisë dhe më pas i sillnin në Tiranë.

Dy të arrestuarit më 1 Prill, u kapën me 2 armë zjarri të dyshuara të trafikuara nga Kosova. Ndërsa hetimet për këtë grup kanë vijuar duke çuar në arrestime të reja. Operacioni u zhvillua në 2 lokale, në Vorë dhe Laprakë në Tiranë.

Policia bëri të mundur sekuestrimin e 14 armëve zjarri (12 pistoleta, njëra prej tyre me silenciator, dhe 2 automatikë), 2077 fara cannabisi, krehra dhe municion luftarak, 3 automjete dhe 8 celularë.



LEXO EDHE:
**Dy punëtorë nga Kosova humbin jetën në një aksident tragjik në Itali**

Burime për Report Tv bëjnë me dije se dyshohet se grupi kriminal i trafikut të armëve ka një bazë në Burrel, për të cilën vijojnë kërkimet. Anëtarët e grupit i sillnin armët nga Kosova me makina rasti, të cilat janë dokumentuar, por dyshimet janë edhe për përdorim të autobusëve të linjave.

Pistoletat e kapura shiteshin në disa qytete, përfshirë Tiranën, Shkodrën dhe me gjerë me 1500-2500 euro copë. Njëra prej tyre, me silenciator, do të shitej të paktën 3000 euro. Armët do të ekspertohen në laborator nëse janë përdorur më herët në krime të tjera.

| |
|---|
| **EMRAT e të arresturave** |
| 1. Emirel Tusha, 32-vjeç |
| 2. Leandro Haxhiaj, 21-vjeç |
| 3. Fabricio Berberi, 26-vjeç |
| 4.Rikardo Hajdaraj, 21-vjeç |
| 5. Visar Murati, 23-vjeç |
| 6. Kevin Farruku, 18-vjeç |
| 7.Geraldo Muraj, 22-vjeç |
| 8. Adriano Shehu, 23 vjeç |
| 9. Altin Pajaziti ( i arrestuar më 1 prill) |
| 10. Kadri Prushi ( i arrestuar 1 prill) |
| **Në kërkim janë shpallur** |
| 1. R.K., 41-vjeç |
| 2. A. N., 24-vjeç |

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:39

## VIDEO e momentit kur shkëmbejnë armët, trafikantët bien në kurth nga blerja e simuluar

Pamje të reja janë publikuar nga operacioni “Puzzle” ku u godit një rrjet i trafikut të armëve nga Kosova në Shqipëri, me qëllim shitjen e tyre.

Për dokumentimin e shitjes së tyre, Antitrafiqet e Tiranës përdorën dron dhe përgjues.

Në këtë video të siguruar nga policia dallohet qartë shkëmbimi i armëve dhe se si trafikantët bien në kurth në një blerje të simuluar.

Grupi kriminal i trafikut të armëve i goditur nga Antitrafiqet e Tiranës i sillte armët nga Kosova me makina rasti siç edhe shihet nga video e mësipërme, por megjithatë dyshohet se mund të kenë përdorur edhe autobusë të linjave.

Gjatë këtij operacionit 10 persona ranë në pranga ndërsa u sekuestruan 14 armë zjarri (12 armë zjarri pistoletë, njëra prej tyre me silenciator dhe 2 automatik), 2077 fara kanabisi, krehra e municion luftarak, 3 automjete, dhe 8 aparate celular.

Armët zakonisht shiteshin në disa qytete, përfshirë Tiranën, Shkodrën dhe me gjerë me 1500-2500 euro copë. Njëra prej tyre, me silenciator, do të shitej të paktën 3000 euro.

Xh.K/Shqiptarja.com

Share

Ora 10:39

## Një pistoletë shitej deri në 2500 euro, detaje nga operacioni në Tiranë! Grupi dyshohet se ka bazë në Burrel! Si ranë në ‘kurth’ me blerje të simuluara

Grupi kriminal i trafikut të armëve i goditur nga Antitrafiqet e Tiranës i sillte armët nga Kosova me makina rasti, të cilat janë dokumentuar, por dyshimet janë edhe për përdorim të autobusëve të linjave. Pistoletat e kapura shiteshin në disa qytete, përfshirë Tiranën, Shkodrën dhe me gjerë me 1500-2500 euro copë. Njëra prej tyre, me silenciator, do të shitej të paktën 3000 euro.

Për dokumentimin e veprimtarisë kriminale u kryen edhe blerje të simuluara. Operacioni për arrestimin e personave të përfshirë në trafik armësh u zhvillua në 2 lokale, në Vorë dhe Laprakë në Tiranë. Nga hetimet e deritanishme, hetuesit dyshojnë se grupi ka një bazë në Burrel, për të cilën vijojnë kërkimet. Armët do të ekspertohen në laborator nëse janë përdorur më herët në krime të tjera.

***Njoftimi i policisë:***

*DVP Tiranë/Punë hetimore dhe operacionale për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të armëve të zjarrit nga Kosova në Shqipëri.*

*Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar "Puzzle", pas një hetimi 5-mujor me metoda proaktive.*

*Operacioni u zhvillua nga Seksioni për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën Operacionale të DVP Tiranë, në drejtimin e Prokurorisë.*

*Sekuestrohen 14 armë zjarri (12 pistoleta, njëra prej tyre me silenciator, dhe 2 automatikë), 2077 fara cannabisi, krehra dhe municion luftarak, 3 automjete dhe 8 celularë.*

*Gjatë periudhës hetimore janë identifikuar 12 shtetas që trafikonin armë zjarri, kryesisht nga Kosova në Tiranë. 10 prej tyre janë vënë në pranga, ndërsa 2 janë shpallur në kërkim.*

*Specialistët e Seksionit për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, në bashkëpunim me Forcën Operacionale të DVP Tiranë, në drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në vijim të punës hetimore dhe operacionale për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të armëve, pas një hetimi 5-mujor me metoda proaktive, kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar "Puzzle".*

*Në kuadër të operacionit bazuar në informacionet e siguruara nga hetimi për disa shtetas që dyshohej se trafikonin armë zjarri, kryesisht nga Kosova në Tiranë, me qëllim shitjen, janë vënë në pranga shtetasit: E. T., 32 vjeç, L. H., 21 vjeç, F. B., 26 vjeç, R. H., 21 vjeç, V. M., 23 vjeç, K. F., 18 vjeç, G. M., 22 vjeç dhe A. Sh., 23 vjeç. Gjithashtu, u shpallën në kërkim shtetasit R. K., 41 vjeç dhe A. N., 24 vjeç.*

*Nga hetimet dyshohet se këta shtetas, pasi siguronin armë zjarri kryesisht në Kosovë por dhe në qytete të ndryshme të Shqipërisë, i sillnin ato në Tiranë, për t'i shitur.*

*Gjatë periudhës hetimore, në kuadër të këtij procedimi, më datë 01.04.2025, janë ndaluar shtetasit A. P dhe K. P., pasi u kapën në flagrancë me 2 armë zjarri, të dyshuara të trafikuara nga Kosova, me qëllim shitjen në Tiranë.*

*Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit K. F, shërbimet e Policisë gjetën e sekuestruan 2077 fara cannabisi.*

*Punohet për kapjen e shtetasve në kërkim dhe për dokumentimin e plotë të kësaj veprimtarie kriminale.*

*Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë nën drejtimin e Prokurorisë së Tiranës po bashkëpunojnë intensivisht me autoritet policore kosovare për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.*

*Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.*

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:45

## Operacioni 'Puzzle', momenti kur policia shtrin në tokë disa nga trafikantët e armëve të zjarrit dhe u vë prangat (VIDEO)

Publikohen pamjet e operacionit "Puzzle", në kuadër të të cilit u vunë në pranga 10 persona ndërsa u shpallën në kërkim dy të tjerë për trafik armësh nga Kosova drejt Shqipërisë.

Në pamje shihet teksa policia, për të kapur njërin prej tyre, ndërhyn në një lokal ku ai ndodhet.

Një tjetër ndalohet teksa ndodhet në ambient të jashtëm. 'Policia, policia shtrihu përtokë…", dëgjohet të thotë një efektiv.

Policia ka ndarë edhe pamjet e armëve të sekuestruar, dhe bëhet fjalë për 12 pistoleta, një silenciator dhe dy automatikë.

Xh.D/Shqiptarja.com

Share

Xh.K/r.k./Shqiptarja.com

TAG: shqiperi | kosove | trafik armesh | Emirel Tusha | Leandro Haxhiaj | Fabricio Berberi | Rikardo Hajdaraj | Visar Murati | Kevin Farruku | Geraldo Muraj | Adriano Shehu | Altin Pajaziti | Kadri Prushi

Komento

### Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH COM

**Sondazhi i ditës:** 29 Maj, 10:37

**Kuvendi, si e vlerësoni punën e legjislaturës që po mbyllet?**

Pozitive | Negative | Nuk e di

## Lajme të tjera

Sistemi zgjedhor në Kosovë nuk është për t'u marrë si shembull

Ervis Iljazaj

30 Maj, 10:27

Ndeshja me Serbinë, Jenishehri letër Sylvinhos: Më lejoni t'ju ndihmoj të fitoni, për 3-4 ditë futbollistët do të kenë progres

30 Maj, 10:25

Mbretëria e Bashkuar shpreh shqetësim për mbylljen e institucioneve serbe në veri të Kosovës

29 Maj, 20:35

'Jemi krah për krah me SHBA dhe aleatët', Presidentja Osmani: Kosova është gati për t'u anëtarësuar në NATO

29 Maj, 19:22

Demush Shasha: Besimi i munguar i Kosovës

Demush Shasha

29 Maj, 15:27

Dhëndër shqiptar, futbollisti i Dortmundit 'çmend' serbët para ndeshjes në Tiranë

29 Maj, 11:32

Kosovë/ Sot dy vite nga protestat e dhunshme në Zveçan, u plagosën më shumë se 90 ushtarë të KFOR-it

29 Maj, 10:15

Vijon ngërçi politik në Kosovë/ Dështon edhe seanca e 23-të për konstituimin e Kuvendit

29 Maj, 08:59

Krasniqi për Report Tv: Presidentja Osmani është nën kërcënime serioze, dyshimet bien mbi shërbimet inteligjente ruse dhe serbe

28 Maj, 19:45

BE-ja kërkon formimin e Qeverisë së re të Kosovës, ambasadori Orav: Kemi nevojë për një partner

28 Maj, 11:39

Ngërçi në Kuvendin e Kosovës, Agim Nesho: Shqetësues, Osmani figurë kyçe për çdo qeveri që do formohet! Kërcënimet ndaj saj s'duhet të neglizhohen

27 Maj, 20:10

Hetimi për fabrikën e përpunimit të produkteve shtazore, kontrolle në ministrinë e Bujqësisë në Kosovë

27 Maj, 13:14

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje